



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri

## INTERVISTA E KRYETARIT TË PREZENCËS PËR RADIO-TELEVIZIONIN SHQIPTAR

*Emisioni “Përballë” nga Lutfi Dervishi  
24 shtator 2019*

**Dervishi:** Përshëndetje! Bernd Borchardt është ambasadori i tetë i OSBE-së në Shqipëri. Ndryshe nga shtatë paraardhësit e tij, ai ka qenë edhe ambasador i Gjermanisë në Tiranë, por emëruesi i përbashkët me shtatë paraardhësit e tij është togfjalëshi “krizë politike”. Kriza të shkaktuara kryesisht nga zgjedhjet problematike. Pas çdo votimi, pasojnë rekomandimet e ODIHR-it. Numri i rekomandimeve vjen duke u rritur, kurse adresimi i tyre i është lënë komisionit bipartizan të reformës zgjedhore. Edhe zgjedhjet atipike të 30 qershorit, që u bojkotuan nga opozita kryesore, nuk u shpëtuan rekomandimeve përkatëse të ODIHR-it. Për herë të parë, rekomandimet u ndanë në dy pjesë: prioritare dhe të tjera. Ne jemi i vetmi vend në rajon që nuk kemi mbyllur ende kapitullin e zgjedhjeve të kontestuara. Politika në Shqipëri ka dështuar për zgjedhjet. Pyetja është: a po dështon edhe komuniteti ndërkombëtar? Debatimi për zgjedhjet në Tiranë zhvillohet me ton dhe intensitet të lartë, sidomos për tri çështje kryesore: sistemin, votën e emigrantëve, votimin elektronik. Asnjë prej këtyre çështjeve nuk është në listën e gjatë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. Vendi është në një krizë politike, por, në tetor, pret vendimin e Këshillit Evropian dhe, në janar, merr kryesimin e OSBE-së. A mundet OSBE-ja në Tiranë të ulë palët, si dikur, dhe të imponojë një reformë zgjedhore në mënyrë që në zgjedhjet e radhës, kurdo qofshin ato, rekomandimet e ODIHR-it të jenë, më në fund, të plotësuara. Sonte, në “Përballë”, është ambasadori i OSBE-së, Bernd Borchardt. Ambasador, mirëmbërë dhe mirëserdhe në program!

**Ambasadori Borchardt:** Falemnderit!

**Dervishi:** Nëse mund ta nisim me një takim të pasdites së sotme, me kryetarin e Partisë Demokratike dhe kryetarët e partive të tjera opozitare. Çfarë lajmi keni për të ndarë me ne, që nuk është ende publik?

**Ambasadori Borchardt:** Folëm rreth veprimtarisë që do të organizojmë nesër, së bashku me parlamentin lidhur me reformën zgjedhore dhe e informova z. Basha rreth përmbajtjes, organizimit, etj.

**Dervishi:** I paraqitët programin apo edhe e bindët që opozita duhet të marrë pjesë në tryezë?

**Ambasadori Borchardt:** Natyrisht, nxita pjesëmarrjen e opozitës në këtë diskutim.

**Dervishi:** Z. Ambasador, çfarë prisni nga takimi nesër?

**Ambasadori Borchardt:** Gjëja kryesore që pres dhe që shpresoj se do ta arrijmë është që të kemi një debat konstruktiv dhe të hapur. Vitin e kaluar, organizuam tetë konferenca me Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore lidhur me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Pati pak rekomandime të reja pas zgjedhjeve të fundit, por Komisioni dëshiron të diskutojë edhe rreth ndryshimit të sistemit zgjedhor, pra jo vetëm për ndryshime në organizimin e zgjedhjeve, por edhe të vetë sistemit. Takimi i nesërm është një lloj takimi fillestar, por, me shumë gjasë, në të do të flitet edhe për rekomandimet.

**Dervishi:** Liderët e opozitës, përfshirë edhe zotin Basha, kanë shprehur shqetësim ose kanë kërkuar publikisht pse nuk jeni prononcuar personalisht për raportin e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e 30 qershorit?

**Ambasadori Borchardt:** Faleminderit për këtë mundësi për t'i sqaruar gjërat. E kemi theksuar dhe vënë në dukje shumë herë se ODIHR-i, organizata jonë me seli në Varshavë, është një institucion i pavarur i OSBE-së, plotësisht i pavarur prej nesh. Ata janë i vetmi institucion i OSBE-së, që ka mandate për të vëzhguar dhe monitoruar zgjedhjet, në mbarë zonën e OSBE-së, pra, jo vetëm në vendet ku gjenden misionet e OSBE-së. Pastaj, ata nxjerrin raporte rreth organizimit të zgjedhjeve dhe fushatave zgjedhore. Kolegët tanë do të vijin sërish në Shqipëri, së shpejti, për të paraqitur raportin e tyre si dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve lidhur me të. Nga ana tjetër, ne si Prezenca e OSBE-së në Shqipëri e mbështesim reformën zgjedhore në kuadrin e programeve tona, për shembull, përmes projekteve që kanë për objektiv ndërtimin e institucioneve dhe fuqizimin e kapaciteteve, si edhe përmes këshillave dhe rishikimeve ligjore, edhe për zbatimin e rekomandimeve. Mirëpo, edhe do të dëshiroja ta theksoja faktin se ne nuk kemi mandat për të monitoruar zgjedhjet. Asnjë mision i OSBE-së nuk e ka një mandat të tillë. Si rrjedhojë, nuk komentojmë rreth gjetjeve specifike të raporteve. Asnjë mision nuk e bën një gjë të tillë. Kjo pasi është në duart e një organizate të specializuar, e cila ka njohuri pa fund në sajë të qindra proceseve zgjedhore të vëzhguara. Ajo që mund të them është se, natyrisht, ne si Prezenca e mbështesim përfundimet e raportit të ODIHR-it. Është normale që misionet e OSBE-së të mbështesin raportet e kolegëve të tyre, por ne nuk kontribuojmë në hartimin e tyre. Mund të shtoj se, më pas, ne punojmë me rekomandimet që përmban raporti dhe përpiqemi ta ndihmojmë Shqipërinë që t'i integrojë ato në Kodin Zgjedhor apo në ligje të tjera. Natyrisht, më vjen shumë keq që ODIHR-it iu desh sërish të thotë se shumë prej rekomandimeve të tyre të mëparshme gjatë viteve të fundit kanë mbetur deri më sot pa u adresuar. Se si i interpretojnë partitë politike përfundimet e raportit, ky është vendimi i tyre, i cili bazohet në interesat e tyre. Po ashtu, partitë politike e dinë se nuk mund të komentojmë rreth gjetjeve të raportit.

**Dervishi:** Po mirë, ata e dinë që ju nuk mund të komentoni, por publikisht ata kërkojnë që ju të shpreheni për raportin.

**Ambasadori Borchardt:** Po, por, sikurse e thashë, kjo nuk është në mandatin tonë.

**Dervishi:** Z. Ambasador, ju thatë se delegacioni i ODIHR-it do të vijë sërish në Shqipëri së shpejti. Kur dhe pse?

**Ambasadori Borchardt:** Ata e kanë botuar raportin dhe tani vihen në dispozicion për ta diskutuar. Data se kur do të vijë është ende duke u vendosur.

**Dervishi:** Si e shpjegoni faktin që, le të marrim katër zgjedhjet e fundit, kemi një template, që përsëritet: zgjedhje-rekomandime, zgjedhje-rekomandime. Nëse dikush ju pyet pse nuk plotësohen këto rekomandime nga njëra palë zgjedhje në tjetrën, a keni përgjigje?

**Ambasadori Borchardt:** Ne kontribuam shumë pas zgjedhjeve të vitit 2017. Në fund të 2017-s deri në verën e 2018-s, organizuam tetë konferenca, sikurse ajo e nesërmja, duke sjellë ekspertë të huaj lidhur me të gjitha çështjet e trajtuara në to, si për shembull regjistrimi i zgjedhësve, trajtimi i shitblerjes së votës, por edhe me çështje që nuk bënin pjesë të rekomandimeve, si përdorimi i teknologjive të reja në zgjedhje, i njohur ndryshe edhe si votimi

elektronik, vota e emigrantëve. Gjatë këtyre konferencave, paraqitëm praktikat më të mira dhe përvojat e mira të vendeve të tjera. Në fund, nuk u arrit konsensusi, megjithëse iu afruam atij shumë më tepër se në vitin 2017.

**Dervishi:** Sa larg jemi konsensusit sot?

**Ambasadori Borchardt:** Zhvillimet e muajve të fundit, sigurisht, nuk ishin të dobishme për arritjen e një konsensusi dhe kjo ishte një prej arsyeve të takimit të sotëm me Kryetarin e Partisë Demokratike dhe përfaqësues të tjerë të saj. Kjo mund të jetë një fushë ku dialogu mund të ringjallet.

**Dervishi:** A shikoni ju shenja, një mjedis që bën të mundur që të ketë një dialog mes pozitës dhe opozitës?

**Ambasadori Borchardt:** Besoj se zbatimi i rekomandimeve të ODIHR-it dhe, nëse ata bien dakord, edhe reformimi i sistemit zgjedhor, që e duan veçanërisht partitë e vogla, mund të jetë një fushë ku mund të vijojë dialogu. Kjo është një çështje mjaft racionale, ku kemi përparësitë dhe dobësitë e sistemeve të ndryshme zgjedhore. Sa u përket rekomandimeve, kemi tashmë një bazë të gjerë rezultatesh nga diskutimet e viteve 2017-2018 mbi të cilën mund të ndërtohet, dhe nesër që të dyja këto do të jenë mbi tryezë me fokus të thelluar në çështjet e lidhura me sistemin.

**Dervishi:** Po vras mendjen, z. Ambasador, si ndihen zyrtarët shqiptarë kur u vihet përpara paragrafi 25 i dokumentit të Stambollit i OSBE-së, që obligon të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së që menjëherë të trajtojnë vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it. Është fjala “follow up promptly”. Pse mendoni që Shqipëria po dështon në përmbushjen e këtij angazhimi të madh?

**Ambasadori Borchardt:** Pas nuk është gjetur konsensusi politik, pasi zhvillimet u errësuan nga çështje të tjera të debatueshme. Po, është për të ardhur keq, kjo është e vërteta.

**Dervishi:** Raporti publik i OSBE/ODIHR-it është lexuar ndryshe nga qeveria dhe ndryshe nga opozita. Si e shpjegoni këtë lexim kaq të ndryshëm për një gjë që e kanë përjetuar të gjithë?

**Ambasadori Borchardt:** Këtë e kemi parë përgjatë viteve, pra, që opozita ndalet në pjesët kritike të raportit, ndërsa qeveria në pjesët pozitive. Pra, le të themi, humbësi merr pjesët kritike, kurse fitimtari pjesët pozitive, gjë që, pjesërisht, është normale për politikën.

**Dervishi:** Z. Ambasador, ju e njihni rajonin prej së paku prej 20 vitesh. Pse Shqipëria nuk po arrin dot të bëjë, në gjykimin tuaj, zgjedhje të pakontestuar? I vetmi vend.

**Ambasadori Borchardt:** Keni pasur disa rotacione pushteti. Përherë ka pasur ankesa, por ndryshimi i pushtetit në vitin 2005 – nuk gjendesha këtu asokohe, por me sa di është kështu – ishte i pakontestuar; po ashtu edhe në vitin 2013 ishte i pakontestuar. Kjo është ana gjysmëplot e gotës. Natyrisht, kemi pasur edhe debate masive në drejtim të kundërt. Isha këtu në vitin 2009, gjatë fushatës “Hap kutitë”, dhe po ashtu kam ndjekur debatet masive që pasuan zgjedhjet e vitit 2017.

**Dervishi:** Ju folët për gotën e mbushur përgjysmë ose që është gjysmë bosh. Por ndonjëherë shikojmë përpjekje edhe për ta thyer gotën.

**Ambasadori Borchardt:** Ndoshta tërmeti i së shtunës theu ca gota, por gota e politikës vijon të qëndrojë në këmbë. Le të themi që është gjysmë plot.

**Dervishi:** Z. Ambasador, rekomandimi prioritar nr. 1, pas 30 qershorit, është që partitë politike të ulen në dialog për reformën dhe të adresojnë rekomandimet e tanishme dhe të mëparshme. E shihni ju të mundur një gjë të tillë?

**Ambasadori Borchardt:** Shpresoj se do të ndodhë dhe unë e nxis. Prezenca me ekspertizën e saj të brendshme, atë të ekspertëve që sjell dhe me ekspertizën e ODIHR-it, do të ndihmojë në çuarjen përpara të këtij diskutimi në drejtime të arsyeshme. Shqiptarët, në të dyja kampet politike, po nxiten fuqimisht nga shumë miq të Shqipërisë për t'u ulur në dialog dhe për të zgjidhur këto çështje zgjedhore, veçanërisht sa u takon rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it.

**Dervishi:** Po, por tryeza e nesërme ka të bëjë me sistemin, ndërkohë që ndryshimi i sistemit nuk është pjesë e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, së paku që nga viti 2003 kur ka qenë pjesa e Dushkut.

**Ambasadori Borchardt:** E vërtetë. Ne, Prezenca dhe ODIHR-i, nuk rekomandojmë ndonjë sistem zgjedhor të veçantë dhe, sigurisht, nuk imponojmë asnjë syresh. Ajo që mund të bëjmë është të ofrojmë njohuri për përparësitë dhe të metat e sistemeve të ndryshme zgjedhore. Me kaq mund të kontribuojmë në këtë diskutim. Partitë politike ndiejnë nevojën për të diskutuar për këtë. Dëgjoj njerëz që argumentojnë se ndryshimi i sistemit do ta bënte shitblerjen e votës shumë më të vështirë. Pra, është legjitime të diskutohen këto çështje dhe ne sjellim përvojën dhe ekspertizën tonë në këtë kontekst.

**Dervishi:** Z. Ambasador, Kodi Elektorale në Shqipëri është nga kodet më të detajuara, ndoshta në kontinent. Plus kemi edhe ligjin e dekriminalizimit. Çështja është: a ka vullnet për t'i adresuar problemet? Sepse, nëse i referohem rekomandimit prioritar nr. 6, thotë që agjencitë ligjzbatuese duhet të hetojnë të gjitha akuzat për zhvillim të zgjedhjeve, në mënyrë të shpejtë dhe transparente. D.m.th., në vend që të ndryshojmë sistemet dhe të amendojmë kodet, a nuk është koha për t'u përqendruar pse nuk zbatohen dispozitat aktuale?

**Ambasadori Borchardt:** Disa nga dispozitat ekzistuese kërkojnë qartësim të mëtejshëm. Kjo thuhet edhe në raport. Aspekte të tjera, sigurisht, janë çështje të vullnetit politik. Më duket se ka qenë Lenini që ka thënë "Beso dhe kontrollo" dhe ndonjëherë edhe Lenini kishte të drejtë. Pra, mund të ketë mekanizma kontrolli në Kodin Zgjedhor. Për shembull, për të pasur një institucion të pavarur që të merret me akuzat për keqpërdorimin e administratës publike, për presionet ndaj administratës publike; për një standard për sinjalizuesit dhe për mbrojtje për njerëzit që informojnë këtë institucion presionet ndaj administratës publike. Këto janë rekomandime të ndërthurura nga zgjedhjet e viteve 2017 dhe 2019. Pra, mund të bëhet më shumë në fushën e organizimit të zgjedhjeve. I vlefshëm është edhe debati nëse, pas më shumë se dhjetë vjetësh, a është sistemi zgjedhor ende më i miri, a i plotësoi ai shpresat që shqiptarët kishin në të në 2008-n, kur u miratua për zgjedhjet e 2009-s.

**Dervishi:** Ju cituat një thënie nga Rusia: "beso, kontrollo". Por çështja këtu është se mungon elementi i parë, që është besimi.

**Ambasadori Borchardt:** Jam dakord. Po, niveli i besimit në politikë është habitshëm i ulët, është e vërtetë.

**Dervishi:** Ju jeni shprehur, më 23 prill, dhe keni thënë që duhet të mendojmë për një zgjidhje dhe kjo zgjidhje duhet gjetur në Shqipëri. Sipas jush a ka një zgjidhje, a shihni një zgjidhje, a shihni një kornizë se si mund të akomodohej një zgjidhje e mundshme, aktualisht?

**Ambasadori Borchardt:** Në vendin tim, themi “nëse do, e gjen mundësinë”. Mendoj se kjo i përshtatet më së miri situatës këtu. Ngërçi politik duhet të tejkalohet. Diskutimi për reformimin e sistemit zgjedhor dhe administratës zgjedhore mund të ndihmojë në tejkalimin e tij. Më 2017-2018, mora zemër nga diskutimet e komisionit të posaçëm për reformën zgjedhore. Gjatë konferencave dhe seminareve që zhvilluam me ta, të dy bashkëkryetarët dolën në shumë rekomandime të përbashkëta. Pra, ekziston tashmë një bazë për të cilën duhet të binden edhe deputetët e rinj të opozitës. Por ky është një proces diskutimi. Pra, mund të funksionojë.

**Dervishi:** Ju deklaratën e bëtë përpara zgjedhjeve, e bëtë në prill. Por, në mendimin tuaj, a dhanë zgjidhje zgjedhjet e 30 qershorit?

**Ambasadori Borchardt:** Nuk ishin zgjidhje, por cila ishte alternativa? Të pranoje që të vendoste pakica: “ne nuk marrim pjesë në zgjedhje dhe prandaj zgjedhjet nuk do të zhvillohen”? Kjo do të minonte të tërë sistemin. Kjo është arsyeja se përse i mbështetëm zgjedhjet. Të gjithë ne këtu, dhe mendoj se kjo vlen edhe për kolegët e mi të bashkësisë ndërkombëtare dhe ODIHR-in, mund të kemi kritika për mënyrën e organizimit të zgjedhjeve, por është çështje krejtësisht tjetër nëse zgjedhjet duhet të zhvilloheshin apo jo.

**Dervishi:** Nëse ju do të ishit këshilltari i qeverisë shqiptare, çfarë do t’i këshilloje qeverisë për ta tejkaluar krizën?

**Ambasadori Borchardt:** Po të isha këshilltar i qeverisë shqiptare, mendoj se, pikësëpari, do flisja në mënyrë shumë të sqartë, në këtë skenar imagjinar, dhe me dashamirësi. Pastaj, si diplomat i mirë – nëse jam i tillë, por u takon të tjerëve të gjykojnë – patjetër që do të vlerësoja kryeministrin për deklaratën e tij që partia në pushtet ka vullnetin të diskutojë me opozitën për çdo çështje në interes të vendit, me qëllim zhbllokimin e situatës. Dhe, pastaj, do t’i thosha: “Po përse nuk fillon me çështje konkrete?” Dhe ka shumë çështje për t’u diskutuar: mund të bëhet më shumë në lidhje me korrupsionin; kemi çështjen e reformës zgjedhore. Kur ishin ende në Kuvend, opozita paraqiti një projektligj, që, me sa mbaj mend, e quajtën “çlirimi i politikës nga krimi”, një lloj vettingu për politikanët. Komisioni i Venecias dha opinion shumë negativ për këtë projektligj, ama ai mund të përmirësohet. Komisioni i Venecias tha se, në parim, ideja ishte e vlefshme dhe, kështu, si qeveria edhe opozita – qoftë ajo jashtë kuvendit, qoftë opozita e re në kuvend – duhet dhe munden të zhvillojnë ide rreth atij projektligji. Si kjo ka edhe shumë fusha të tjera.

**Dervishi:** Por nëse e kthejmë pyetjen në krahun tjetër, nëse do të ishit këshilltar i opozitës, çfarë do t’i sugjeronit, si hap i parë?

**Ambasadori Borchardt:** Edhe kjo është pyetje shumë delikate. Misionet e OSBE-së nuk kanë mandat të punojnë me partitë, ne punojmë me institucionet. Gjithsesi, përsëri do të isha po aq i sqartë sa me qeverinë dhe do të diskutoja me dashamirësi. Rekomandimet e mia do të ishin: ju kritikoni qeverinë: “Shumë mirë që kritikoni qeverinë. Ka disa pika për të cilat

bashkohem me kritikën tuaj, por na jepni recetat tuaja. Si të luftohet korrupsioni, për të cilin ju ankoheni shumë dhe, i cili, preku rëndshëm edhe qeverinë tuaj?”

**Dervishi:** Ndjesë që po ju ndërpres. Opozita thotë: ambasador, kemi problem me zgjedhjet se na i blejnë votat, kemi dosjen 184, 350, a çfarë emri ka marrë dhe nuk hetohet. Si mund të jemi në mirëbesim kur ne dhunohemi dhe çështjet nuk hetohen?

**Ambasadori Borchardt:** Mund të krijohen koalicionet. Edhe komunitetin ndërkombëtar e shqetëson korrupsioni. Nëse opozita ka projekte të mira, ajo mund të gjejë aleatë, jo vetëm te komuniteti ndërkombëtar – ne mund të ofrojmë ndihmë teknike – por edhe te të tjerët në vend. Ka shumë fusha. Përmenda pak më parë atë që ata e quajtën pastrimi i jetës politike. Ka edhe mënyra të tjera për të bërë një gjë të tillë, mënyra të ndryshme nga ajo që kishin sugjeruar dhe që u kritikua fort nga Komisioni i Venecias. Le të marrim fushën tuaj, fushën e medias. Aktualisht, po bëhet një diskutim për ligjin kundër shpifjes, siç quhet në publik. Ama, ka edhe shumë çështje të tjera. Gjendja e të drejtave sociale dhe të drejtave të punësimit është problematike për shumë gazetarë. Atëherë, përse të mos propozohen nisma ligjore për të zgjidhur këtë problem? Shumë raporte ndërkombëtare flasin për përqendrimin e medias në Shqipëri: shumë gjëra janë në duart e vetëm pak njerëzve. Atëherë, përse të mos propozohet një ligj antitrust, i cili të mund të pranohet nga Gjykata Kushtetuese, organi që shfuqizoi dispozitat e fundit?

**Dervishi:** Zoti Ambasador, nëse i rikthehem kësaj situatë të polarizimit politik. Edhe raporti i OSBE/ODIHR-it citon një klimë politike ekstremisht të polarizuar, gjë që i pengoi zgjedhësit të bënin zgjedhje. Sa e ndjeni ju personalisht këtë polarizim dhe sa pengon ky polarizim në marrëdhëniet e elitës politike këtu me komunitetin ndërkombëtar?

**Ambasadori Borchardt:** Niveli i polarizimit këtu është shumë i lartë. Kam jetuar dhe kam punuar në shumë vende të tjera të Ballkanit apo të Evropës Juglindore. Edhe atje kam përjetuar mjaft polarizim. Edhe në vendin tim polarizimi ka qenë në rritje për arsye të një opozite më të ashpër të krahut të djathtë, por niveli i polarizimit këtu është i habitshëm. Ai prek edhe komunitetin ndërkombëtar. Unë vetë kam koleksionuar shumë karikatura, që më portretizojnë edhe mua. Ndryshe nga udhëheqësit komunistë, unë nuk koleksionoj autorët e karikaturave, siç bënte Stalini. E kam të vështirë ta kuptoj pse ka kaq shumë agresivitet.

**Dervishi:** Personalisht sa ju pengon në punën tuaj ky polarizim?

**Ambasadori Borchardt:** Ndikon në punën time edhe në punën e të tjerëve. Jo gjithmonë, por tepër shpesh, duhen shumë përpjekje për t'i ulur të gjithë në të njëjtën tavolinë si, për shembull, kur punojmë me përfaqësuesit e kuvendit për çështje të veçanta. Ka pasur shumë njerëz të mirë në Kuvend, ka edhe tani, por një numër i mirë i atyre që u larguan do të kthehen një ditë. Prandaj është për të ardhur keq që ata nuk po marrin pjesë në këto masa. Ky është vetëm një shembull. Është edhe reforma zgjedhore, por për të folëm më parë.

**Dervishi:** Z. Ambasador, a keni menduar ta trajtoni në mënyrë të drejtpërdrejtë problemin e polarizimit politik në programet tuaja?

**Ambasadori Borchardt:** OSBE-ja është për dialog. Ne nxitim dialogun dhe e kemi bërë këtë. Përmenda shembullin e tetë konferencave të vitit të shkuar. Më kujtohen çështjet që u diskutuan atëherë. Me anë të dialogut dhe diskutimeve mjaft intensive, ne arritëm t'i bindim

pjesëmarrësit për idetë që nuk ishin të mira. Pra, po funksiononte, dhe një gjë e tillë duhet të vazhdojë.

**Dervishi:** Ky është dialogu, por, ndonjëherë, a keni menduar se duhet përdorur kërcënimi, kritika e ashpër, bojkoti, anashkalimi?

**Ambasadori Borchardt:** Kjo nuk do të ishte OSBE-ja, e cila, si organizatë, bazohet te dialogu. Ne nuk përdorim kërcënimet. Ne nxisim, përpiqemi të gjejmë argumente. Ne besojmë te forca e argumenteve tona.

**Dervishi:** Z. Ambasador, folëm për zgjedhjet, krizën politike, atmosferën e polarizuar. Pyetja ime është duke iu referuar historisë jo shumë të largët, OSBE-ja ka pasur një traditë që i ulte palët për të zgjidhur krizën politike. A po e konsideroni këtë opsion ende sot që të shërbeni si ndërmjetësues mes palëve, për të nisur një dialog?

**Ambasadori Borchardt:** Këtu erdhi Sekretari i Përgjithshëm i OSBE-së. Erdhi edhe Kryetari në Detyrë, Ministri i Jashtëm i Sllovakisë, Miroslav Lajçak, dhe të dy theksuan, gjatë takimeve me politikanët shqiptarë të të dyja krahëve të spektrit politik, se OSBE-ja patjetër që është e gatshme të lehtësojë, jo të ndërmjetësojë, por të lehtësojë diskutimet për afrimin e palëve, nëse të dyja palët janë dakord. Kjo është mënyra se si ne punojmë: të dyja palët duhet të jenë dakord.

**Dervishi:** Tani që ju përmendët kryetarin në detyrë, m'u kujtua që në janar 2020 kryetari në detyrë mund të jetë Kryeministri ose Ministri i Jashtëm i Shqipërisë. Një nga fushat kryesore të mandatit të OSBE-së është puna që bën për demokracinë. Ju e përmendët pak çështjen e medias. Ka ngjallur një debat të madh dhe ka ndjeshmëri shumë të madhe, jo vetëm në komunitetin e gazetarëve, për projektligjin e ri për mediat online. OSBE-ja duket se ka një qasje për ta përmirësuar draftin. Pyetja ime është: mos është qasja e gabuar, në vend që të përmirësojmë një projektligj, mos duhet të përqendrohemi te legjislacioni ekzistues dhe te vetërregullimi?

**Ambasadori Borchardt:** Po, faleminderit për këtë pyetje të rëndësishme e cila me jep edhe mua mundësinë të bëj disa sqarime. Shpesh, media në Shqipëri përdor termin e përgjithshëm OSBE, duke na njehsuar me institucionet tona të tjera. Më parë, përmenda ODIHR-in në Varshavë. Njëra prej strukturave të OSBE-së është Përfaqësuesi për Lirinë e Medias, me seli në Vjenë. Ky institucion i OSBE-së po punon me qeverinë për përafrimin e të ashtuquajturit "ligji kundër shpifjes" me standardet ndërkombëtare me të cilat Shqipëria ka rënë dakord; kryesisht në kuadrin e OSBE-së, por edhe në kuadrin e Këshillit të Evropës. Harlem Desir, Përfaqësuesi për Lirinë e Medias, ishte këtu. Ai monitoron lirinë e medias dhe ofron mbështetje për hartimin e legjislacionit. Për ne, nuk është pjesë e mandatit tonë të përmirësojmë legjislacionin në këtë fushë. Tani, në lidhje me pyetjen tuaj për qasjen ndaj mediave: ne gjithmonë kemi mbështetur dhe përkrahur vetërregullimin e medias, si alternativë ndaj normimit nga ana e qeverisë, për përballimin e çështjeve si shpifja. Me sa di nga kolegët e mi, ekziston një organ që quhet Këshilli i Medias, i cili përpiqet të forcojë vetërregullimin me anë të një kodi për etikën e medias. Por, nuk ka përparuar shumë, të paktën me aq sa dimë ne. Një tjetër shoqatë vetërregulluese u krijua në vitin 2010 me mbështetjen e OSBE-së dhe BE-së; quhej Klubi Shqiptar i Medias. Ama, mediat më të rëndësishme nuk donin të bëheshin pjesë e saj. Ato ndienin se edhe vetërregullimi është një lloj rregullimi në vetvete, dhe nuk donin të bëheshin pjesë. Vetërregullimi është mënyra e parapëlqyer, kjo nuk diskutohet. Por nëse një gjë e tillë nuk ndodh dhe nëse nuk ka ndonjë

proces organik që të çojë atje, atëherë duhen gjetur mënyra të tjera. E kemi thënë shumë herë që shpifja nuk duhet të hiqet nga Kodi Penal. Por, edhe personat e prekur nga shpifja duhet të kenë të drejtën të mbrohen. Nuk duhet pranuar çdo gjë. Ka një balancë mes lirisë së shprehjes dhe dinjitetit njerëzor. Dhe, nëse nuk ka vetërregullim të medias, atëherë ne jemi më se të gatshëm të mbështesim përpjekje të tjera. Mendojmë se Kodi Civil mund ta mbushë këtë hendek. Kështu ndodh në vendin tim. Deklaratat publike të Përfaqësuesit të Lirisë së Medias dhe kontributi thelbësor i tij te projektligji e kanë bërë shumë të qartë se ku është kufiri sipas nesh: se çfarë mund të bëhet dhe çfarë nuk mund të bëhet. Veçanërisht, problemet duhet të trajtohen në gjykatë dhe jo nga një organ administrativ.

**Dervishi:** Z. Ambasador, përveç këtij projektligji që po diskutojmë, çfarë shikoni ju si problem, si sfidë kryesore që ndeshet sot në mjedisin mediatik në Shqipëri?

**Ambasadori Borchardt:** Përmenda dy çështje më parë, për të cilat mendoj se deputetët duhet të ndërmarrin nisma. E para ka të bëjë me nivelin e lartë të përqendrimit të pushtetit dhe e dyta me gjendjen e të drejtave sociale dhe të punës të gazetarëve. Të dyja këto çështje kanë nevojë për nisma ligjore.

**Dervishi:** Z. Ambasador, por ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe ky vendim, që është për të ardhur keq, ka bërë të mundur që, jo vetëm de facto, por edhe de jure, pushteti i medias të përqendrohet në shumë pak duar.

**Ambasadori Borchardt:** Të interesuarit në fushën politike që merren me këtë duhet ta analizojnë atë vendim dhe të shqyrtojnë se çfarë mund të bëhet në kuadër të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Në shtete të tjera kemi parë hartimin e legjislacionit antitrust. Kjo ka ndodhur shumë kohë më parë, por nuk shumicën e atyre vendeve legjislacioni antitrust nuk u zhvillua brenda natës. Ai u zhvillua ngadalë, u kontestua nëpër gjykata dhe pastaj u zhvillua më tej.

**Dervishi:** Një çështje tjetër që ju përmendët ka të bëjë me të drejtat e gazetarëve, të drejtat e punës të gazetarëve, por, edhe në këtë rast, më shumë se mungesë të legjislacionit, ne nuk kemi zbatim të legjislacionit ekzistues. Mjafton që Inspektorati i Punës të bëjë punën e vet dhe nuk do të ketë gazetarë të paregjistruar në punë apo gazetarë që i marrin rrogat me vonesë.

**Ambasadori Borchardt:** A shkojnë gazetarët tek Inspektorati? Gazetari dokumenton raste, kjo është puna e tij. Ai ka shokë edhe ndërmjet gazetarëve të tjerë. Drejtimi i gishtit ndaj përgjegjësve mund të jetë një zgjidhje.

**Dervishi:** Një pyetje, që mund të tingëllojë pak si konflikt interesi: OSBE-ja mbështet pavarësinë financiare dhe politike të RTSH-së me një projekt afatgjatë me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Çfarë rezultatesh shikoni në këtë bashkëpunim?

**Ambasadori Borchardt:** Unë mendoj se RTSH-ja është zhvilluar shumë. Edhe fakti që jam këtu sonte me ju do të thotë se e pranojmë që jeni një stacion i mirë televiziv. Raporti për zgjedhjet – pavarësisht kritikave ndaj të gjithëve - ju vendonte në një dritë mjaft të mirë. Duhet vullnet politik për ta arritur këtë, duhet konsulencë, duhet ndihmë, duhen profesionistë. Ne jemi shumë optimistë për vijimin e kësaj pune të mirë me RTSH-në në të ardhmen. Jam ndier shumë krenar për kolegët e mi kur ata arritën të sigurojnë fonde të konsiderueshme nga



Bashkimi Evropian për të mbështetur RTSH-në nën drejtimin e OSBE-së dhe që ne mund ta vijojmë këtë traditë të gjatë të bashkëpunimit.

**Dervishi:** Një pyetje më direkte: ju keni qenë në Tiranë në vitet 2007-2010, në kohën që ishit Ambasador i Gjermanisë në Shqipëri dhe, tashmë, në vitet 2016-2019 si ambasador i OSBE-së. Nëse mund të flasim për këto dy periudha, çfarë shikoni ju ndryshe në transmetuesin publik?

**Ambasadori Borchardt:** Dhjetë vjet më parë, RTSH-ja më dukej shumë më pak e kohës. E pranoj se shqipja ime nuk është shumë e mirë, kështu që të kuptuarit është i kufizuar. Deri diku, mund të lexoj lajmet e shkruara. Por perceptimi i përgjithshëm është se RTSH-ja është modernizuar dhe është bërë shumë më e hapur.

**Dervishi:** Nëse flasim për të shkuarën, dhe OSBE-ja është angazhuar me projekte për të ndriçuar të shkuarën në Shqipëri, sa të gjata i shihni ju hijet totalitare të së shkuarës në Shqipëri?

**Ambasadori Borchardt:** Po ju jap dy përgjigje. E para pak si me humor. Jo shumë kohë më parë, gjendesha në një hotel për një konferencë. Kur ishim ende në sallë, jashtë, kamerierët filluan të vendosnin ushqimin e ngrohtë nëpër tavolina. Kur ne dolëm, pas më shumë se gjysmë ore, ushqimi ishte ftohur. Thashë me vete: “Mirë se erdhe në socializmin e vërtetë që ekziston ende, ku kamerieri është zoti dhe klienti vetëm një kërkues i gjorë”. Tani pjesa e dytë e përgjigjes sime, dhe unë e di se ju doni diçka më politike nga unë. Pra, hijet e së shkuarës ekzistojnë, por sa më shumë zgjaten ato, aq më shumë fundoset dielli prapa tyre, mos e harroni këtë. Është normale që hijet të ekzistojnë. Vendit tim iu desh shumë kohë për ta kaluar këtë proces. U deshën njëzet vjet për të hapur çështjen e parë gjyqësore për Aushvicin. U deshën 50 vjet përpara se Gjermania të mund të hapte në të gjithë vendin një ekspozitë të madhe për krimet e ushtrisë gjermane gjatë luftës. Ekspozita u vizitua nga më shumë se 1.2 milionë njerëz dhe pati demonstrata të mëdha kundër saj, më së shumti ish-ushtarë të moshuar në vitet 1990. Dhe kjo ndodhte 50 vjet pas luftës. U desh kaq shumë kohë që gjermanët ta pranonin, ta afronin idenë se krimet e Luftës së Dytë Botërore nuk u bënë vetëm nga Partia Naziste, Gestapo, SS-të, por edhe nga ushtarë të thjeshtë dhe policë të zakonshëm. Dhe ka shumë syresh për të treguar. U desh viti 2000 dhe pak presion nga gjykatat amerikane që ne të fillonim kompensimin e të gjithë njerëzve që ishin sjellë në Gjermani për të punuar si skllëvër, përfshirë shqiptarë, dhe më duhet ta pranoj se ne ishim të fundit që filluam të paguajmë dëmshpërblimet. Prandaj, nuk mendoj se duhet të shqetësohemi për hijet e së kaluarës, ato po davariten. Kemi zhvillime të rëndësishme edhe këtu. Kam dëgjuar se, për herë të parë, një ish-komandant kampi nga koha e komunizmit është akuzuar në gjykatë në Gjermani, ku ai jeton, si dhe nga një gjykatë këtu në Shqipëri, për krime kundër njerëzimit, dhe krimet kundër njerëzimit nuk parashkruhen, çka do të thotë që ato mund të procedohen në çdo kohë. Pra, trajtimi i aspekteve penale të këtyre krimeve është një zhvillim i rëndësishëm. Unë nuk kam asnjë informacion për provat dhe faktet, ndoshta çështja do të dështojë, por gjërat po lëvizin, dhe gjërat lëvizë ngadalë edhe në Gjermani.

**Dervishi:** Dakord, por 30 vjet nuk janë pak për të nisur një ballafaqim serioz, që duket se në Shqipëri mungon.

**Ambasadori Borchardt:** Ju më pyetët për ndryshimet nga koha kur kam qenë këtu si ambasador i Gjermanisë dhe mendoj se kjo është një fushë ku ndryshimet janë vërtet shumë të dukshme. Ka përparim të jashtëzakonshëm: Muzeu i Shtëpisë së Gjetheve; Muzetë Bunkart

1 dhe 2, të cilët japin një pamje shumë realiste të të gjitha të këqijave që ndodhën; Autoriteti i Dosjeve të Sigurimit; Memoriali i Tepelenës; fillimet shumë të ngadalta për të bërë diçka në Spaç; ftesa ime nga Kuvendi për të folur me rastin e 70-vjetorit të vrasjes së 17 parlamentarëve opozitarë në 1947. Të gjithë këta janë hapa që as nuk mund të mendoheshin më 2008-2009. Ka pasur shumë zhvillime për të cilat kanë vrarë mendjen shumë njerëz, përfshirë filozofë dhe shkencëtarë. Ruti Teitel, ndoshta një nga emrat më të spikatur në fushën e drejtësisë tranzicionale, ka thënë - dhe kjo ndoshta është arsyeja pse fola kaq shumë për muzetë dhe memorialet - që duhet të ndajmë dhe të përhapim njohuritë që kritikojnë ideologjinë e regjimeve paraardhëse, dhe se këto njohuri duhet të vijnë përmes provash. Por edhe ka edhe lloje të tjera njohurish për vuajtjet e së kaluarës, që luajnë një rol vendimtar në aftësinë e shteteve për vendosur me sukses një rendi të ri të liberalizuar. Dhe unë mendoj se këto fjalë janë shumë të urta. Shqipëria, siç thashë, ka ndërmarrë hapa të mirë në këtë drejtim. Por jemi ende larg asaj që duhet bërë. Siç po thosha, ushtria gjermane u bë objekt diskutimi 50 vite pas luftës. Pra, rruga është e gjatë dhe gjithmonë do të ketë kundërshti. Por këto polemika për mënyrën sesi duhet ecur përpara dhe për trajtimin e së kaluarës, këto kundërshti dhe debate janë pjesë e përpjekjeve për të bërë paqe me të kaluarën.

**Dervishi:** Nëse i referohemi pak aspektit politik, ju keni thënë që tepër aktorë politikë kryesorë herët a vonë përfundojnë duke e akuzuar njëri-tjetrin me metaforat dhe retorikën karakteristike për mënyrën se si metoda e armikut të popullit e kupton politikën dhe jetën publike. Si i shihni hijet e të shkuarës në jetën politike dhe publike të vendit?

**Ambasadori Borchardt:** Një nga momentet kur mendova për hijet e së shkuarës ishte debati në parlament për Institutin për Krimet e Komunizmit të z. Tufa. Po diskutohet për kufizimin e mandatit të tij vetëm në periudhën e pasluftës. Pra, duket se ka një tabu. Kam pyetur një numër parlamentarësh dhe njerëz të tjerë dhe duket se ka një lloj tabuje. Dhe siç thashë, rruga për kapërcimin dhe trajtimin e këtyre çështjeve kalon vetëm përmes diskutimit, madje edhe kundërshtive.

**Dervishi:** Në qoftë se i rikthehem vlerësimit që ju keni për shoqërinë civile, a mendoni që shoqëria civile në Shqipëri është e vetëdijshme për rolin që luan?

**Ambasadori Borchardt:** 10-12 vjet më parë, shoqëria civile që mbaj mend ishte më e gjallë. Sot, është më e qetë, por kam ende një shpresë të fortë se do të zhvillohet. Një nga ngjarjet që e ushqyen këtë shpresë ishin protestat e studentëve të vitit të kaluar, që treguan se brezat e rinj kanë ç't'i mësojnë çdokujt, të gjithë neve, siç bëmë ne në Gjermani në fillim të viteve 1970, kur unë isha student. Kështu që, unë jam shpresëplotë që shoqëria civile do të rimëkëmbet. Ka gjithmonë periudha përgjumjeje dhe periudha paqeje. Por ka pasur edhe suksese të tjera, për shembull protesta kundër importit të mbetjeve kimike.

**Dervishi:** Po, gjashtë vjet më parë. A e shihni ju si faktor shoqërinë civile? Një faktor ku ju mund të mbështeteni?

**Ambasadori Borchardt:** Ne po punojmë me shoqërinë civile, bëjmë programe me të, sepse duam ta forcojmë. Të dielën e kaluar, bëra një prezantim në një aktivitet që organizonte një nga organizatat e shoqërisë civile, për trajtimin e së kaluarës. Shpjegova, dhashë disa ide se si ishte bërë kjo në Gjermani pas fashizmit dhe komunizmit. Pra, ka lëvizje. Siç e përmendët edhe ju, ne kemi mbështetur dialogun kombëtar për të shkuarën e Shqipërisë dhe, në një masë të madhe, e kemi bërë angazhuar organizata të shoqërisë civile.

**Dervishi:** Z. Ambasador, folëm për zgjedhjet, për politikën, për shoqërinë civile, për median, për ballafaqimin me të shkuarën. Nëse mund të përdornim një emërues të përbashkët: nëse do të kishim një gjyqësor të mirë, ndoshta nuk do të kishim asnjë prej këtyre problemeve. Nuk do të kishim probleme me projektligjin e ri për median, nuk do të kishim problem me kompensimin për të shkuarën, nuk do të kishim problem me grabitjen e zgjedhjeve. Pyetja ime ka të bëjë me gjyqësorin në Shqipëri. Në mandatin tuaj OSBE-ja mbështet reformën në gjyqësor. Në vlerësimin tuaj, është sistemi i drejtësisë në Shqipëri në gjendje që të ngrihet në këmbë dhe të japë drejtësi njëlloj si për ata që munden, si për ata janë krejt të pamundur?

**Ambasadori Borchardt:** Është në proces. Refor800 ma në drejtësi po vijon, dhe reforma në drejtësi është shumë më tepër se sa procesi i famshëm i vettingut, i cili tashmë ka nxjerrë jashtë shumë gjykatës, kryesisht për shkak të pasurisë së pashpjegueshme. E di që ka akoma shumë probleme që presin zgjidhje. Më sa di, janë shqyrtuar 170 nga 800 gjyqtarë e prokurorë, pra, procesi është ende në vijim. Po ashtu, po ngrihen institucionet e reja të drejtësisë. Në një të ardhme jo shumë të largët, do të ketë një prokurori dhe gjykatë speciale për korrupsionin e nivelit të lartë dhe krimin e organizuar. Gjërat, dalëngadalë, po shkojnë në vendin e tyre dhe, në një të ardhme jo aq të largët, madje disa hapa do të hidhen për disa muaj, Shqipëria do të ketë një sistem shumë më të mirë.

**Dervishi:** Nëse flasim për një periudhë 10-vjeçare, ka gjëra që Shqipëria ka progres për shkak të kohës, për shkak të zhvillimeve teknologjike, por ka edhe hapa prapa dhe një nga këto është korrupsioni. Në renditjen e Transparency International, Shqipëria është shumë më keq sot se sa ka qenë dhjetë vjet më parë. Çfarë po çalon në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri?

**Ambasadori Borchardt:** Gjithsesi, Shqipëria në renditjen e “Transparency International” paraqitet pak më mirë se sa dhjetë vjet më parë. Por në të njëjtën kohë, më duhet të pajtohem me ju, pasi është shumë për të ardhur keq që vlerësimi për Shqipërinë është përkeqësuar në dy vitet e fundit. Ne i kemi ofruar qeverisë mbështetjen tonë dhe po i kërkojmë të bëjë më shumë në këtë fushë. Unë, gjithashtu, do të nxisja edhe opozitën të paraqesë ide të vlefshme se çfarë mund të bëhet më mirë.

**Dervishi:** Nëse flasim për këtë dekadë që ju e njihni Shqipërinë, le të themi që nga viti 2007, çfarë ka humbur Shqipëria gjatë këtyre 10-12 viteve?

**Ambasadori Borchardt:** Do ta filloja me gjërat, për të cilat nuk më vjen aspak keq që Shqipëria i ka humbur. Ka humbur duhanpirësit në restorantet dhe kafenetë e Tiranës, rrugët e këqija me shumë gropa, ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike, plazhet ku flitej vetëm shqip, ndërsa sot, në to, mund të dëgjosh gjysmën apo të paktën një të tretën e gjuhëve të Evropës. Ka humbur tregun e rrënuar pranë sheshit “Avni Rustemi”, i cili u zëvendësua me Pazarin e Ri. Ka humbur qindra dyqane bastesh dhe lojërash fati. Por, ka edhe gjëra për të cilat më merr malli...

**Dervishi:** Atëherë, le të themi çfarë ka fituar, se me humbjet jemi të gëzuar, por çfarë kemi fituar?

**Ambasadori Borchardt:** Ka pasur edhe gjëra për të cilat më vjen keq që i kemi humbur. Më pëlqente stadiumi i vjetër. Po, këndvështrimi im estetik për të mbase ndryshon nga ai i të tjerëve. Më pëlqenin edhe zonjat e moshuara në rrugë, që shisnin produkte pa kimikate nga kopshtet e tyre dhe që pas një muaji ose gjashtë javësh, më kishin mësuar emrin dhe më

përshëndesnin. Kjo të jep një ndjesi ndryshe nga ajo e një dyqani anonim. Pra, progresi ka kosto.

**Dervishi:** Ju dëgjohej më shumë fjala kur ishit ambasadori i Gjermanisë në Tiranë apo tani që jeni Kryetari i Prezencës së OSBE-së?

**Ambasadori Borchardt:** Ia bëj edhe vetes këtë pyetje dhe e kam vështirë të përgjigjem, sepse kur isha ambasador i Gjermanisë merresha me çështje të tjera. Në përgjithësi, e nxisja Shqipërinë që bënte përpara me reformat, por çështjet ku si ambasador dypalësh dëshiroja të shihja rezultate konkrete dhe progres ishin shpesh çështje të investitorëve gjermanë në Shqipëri, qoftë investitorët ekonomikë, qoftë organizatat që mbështesnin zhvillimin e vendit. Zhvilloja takime në ministri dhe me ministra për t'u kërkuar që t'i trajtonin më mirë. Tani, nuk kam mandat për t'u marrë me çështje ekonomike. Ne nuk ofrojmë mbështetje për individët nga Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kur ata kanë probleme personale me sistemin juridik këtu, ose kur ata ndiejnë se po trajtohen padrejtësisht. Si ambasadë apo ambasador gjerman, ishte fdetyra jonë të mbështesnim qytetarët gjermanë, t'i ndihmonim ata. Kurse tani jam në një fushë tjetër.

**Dervishi:** Z. Ambasador, faleminderit që ishit sonte në televizionin publik shqiptar!

**Ambasadori Borchardt:** Faleminderit shumë! Ishte kënaqësi e madhe.

**Fund**